



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 98
Prishtinë, më 28 janar 2010

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 28 JANAR 2010**

Seancën e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 71 deputetë.

Para procedimit me rend të ditës, për fjalë u paraqit deputetët Ali Lajçi dhe Drita Maliqi.

Ali Lajçi tha se është e udhës që Kuvendi të bëjë një deklaratë lidhur me gjykimin e Albin Kurtit nga ana e EULEX-it.

Drita Maliqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, reagoi lidhur me, siç tha ajo, presionet e subjekteve të caktuara për rirreshtime politike nga subjekte të caktuara. Ajo përmendi edhe çështjen e mos ekzekutimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 19 janar 2010, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, Kryesia e Kuvendit, në pajtim me Rregullën 23.1 të Rregullores së Punës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2010, ka vendosur që Kuvendit t'i propozojë edhe dy pika shtesë për seancën e sotme plenare:

1. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndarjen mjeteve financiare për RTK-në,
2. Propozim-vendimi i Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale.

Kryetari kërkoi nga deputetët të deklarohen përmes një votimi formal për propozimin lidhur me pikat shtesë.

Kuvendi miratoi propozimin këtyre pikave shtesë.

Kryetari tha se pikat shtesë do të radhiten për shqyrtim si pikë e 14-të, përkatësisht e 15-të e rendit të ditës.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 29 dhjetor 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mjekësinë Ligjore,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,
14. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndarjen e mjeteve financiare për RTK- në,
15. Propozim-vendimi i Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 29 dhjetor 2009

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 29 dhjetor 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, lidhur me mbrojtjen e të drejtave elementare të punëmarrësve në Kosovë, në mungesë të Ligjit të punës dhe mungesës së dialogut social në vend.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministrin e arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me tenderin për pajisjen e shkollave me teknologji informative.

Ministri Enver Hoxhaj i'u përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja **Teuta Hadri** parashtroi pyetje për ministrin e shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me mospagesën e kujdestarive të punëtorëve shëndetësorë, nga viti 2009.

Ministri Alush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadri.

Deputetja **Drita Maliqi** parashtroi pyetje për ministrin e arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me ndryshimin e Kurrikulit nga niveli parashkollor deri në klasën e 9-të dhe përfshirjen e eksperteve të barazisë gjinore në komisionet për ndryshim.

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** parashtroi pyetje për ministrin e arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me projektet për ndërtimin e shkollave dhe pagesën e atyre projekteve.

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes **Kadaj-Bujupi**.

Deputeti **Emrush Xhemajli** parashtroi pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, lidhur me aktivitetet e ministrisë për vendosjen e dialogut social përmes funksionalizimit të Këshillit Ekonomik e Social.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit **Xhemajli**.

Deputeti **Shkumbin Demaliaj** parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me ekzistimin e strukturave paralele në Republikën e Kosovës.

Kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Demaliaj.

Deputetja **Qamile Morina** parashtroi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me prolongimin e realizimit të projektit për themelimin e Kardiologjisë publike.

Ministri Alush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Morina.

Deputetja **Njomza Emini** parashtroi pyetje për ministrin e Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, lidhur me informacionet e kësaj ministrie për gjendjen e shtetasve të Kosovës që punojnë në Haiti, pas tërmetit katastrofal që goditi këtë vend.

Ministri Skender Hyseni i'u përgjigj pyetjes së deputetes Emini.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës

Kryesuesi Naim Maloku ftoi ministrin e Shëndetësisë që para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

Ministri **Alush Gashi** tha se ky projektligj, Kryqin e Kuq të Kosovës e paraqet si një shoqatë e nivelit kombëtar dhe vullnetare, humanitare, jofitimprurëse, e cila zhvillon aktivitetin e saj në tërë teritorin e Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, tha se projektligji adreson çështjet që kanë të bëjnë me fushëveprimin e Kryqit të Kuq, siç janë: veprimtaritë humanitare, njohuritë mbi lëvizjen e Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe, edukimin shëndetësor, mbrojtjen e të drejtave të njeriut etj.

Projektligji është i hartuar në pajtueshmëri me Konventën e Gjenevës të 12 gushtit 1949, Statutit të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe Statutit të Kryqit të Kuq të Kosovës, theksoi ministri.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nurishahe Hulaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, si dhe deputetët: Numan Baliq, Mahir Jagcillar, Riza Smaka, Naser Rugova, Luljeta Shehu, Vezira Emrush, Drita Kadriu, Nekibe Kelmendi dhe Alush Gashi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve

Kryesuesi ftoi ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, që para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

Ministri **Alush Gashi** tha se ky Projektligj rregullon përdorimin, mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, të Gjysmëhënës së Kuqe dhe Kristalit të Kuq, në kohën e konfliktit të armatosur dhe në paqe.

Në vazhdim, tha se për zbatimin e këtij ligji përgjegjësia i takon Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Hadri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nurishahe Hulaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Syla, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, si dhe deputetët: Mahir Jagcillar, Bahri Hyseni, Eqrem Kryeziu dhe Riza Smaka, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale

Kryesuesi ftoi ministrin e Shëndetësisë që para deputetëve ta prezantojë projektligjin.

Ministri **Alush Gashi** tha se ky projektligj është hartuar sipas kriterëve dhe standardeve për hartimin e legjislacionit, kurse e veçanta e këtij projektligji është pjesëmarrja e ekspertëve të farmacisë në hartimin e tij.

Projektligji rregullon prodhimin, regjistrimin, tregtimin, sigurinë dhe përdorimin e produkteve dhe të pajisjeve medicinale në Kosovë, tha ministri.

Ai më tutje tha se këtij ligji do t’i nënshtrohen si autoritetet publike, ashtu edhe personat juridikë dhe fizikë që merren me prodhimin dhe tregtimin e produkteve dhe të pajisjeve medicinale.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Hadri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nurishahe Hulaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Syla, në emër të

Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, si dhe deputetët: Riza Smaka dhe Alush Gashi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,
Kundër-----10,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Projektligjin për produktet dhe pajisjet medicinale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari, në pjesën e punimeve të pas ditës propozoi që për shkak të rëndësisë së çështjeve, pika e 14-të dhe e 15-të të rendit të ditës të shqyrtohen në vazhdim të seancës së sotme plenare.

Ai kërkoi një votim formal nga deputetët për propozimin e paraqitur.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin për shqyrtimin në vazhdim të pikës së 14-të dhe të 15-të të rendit të ditës.

14. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndarjen mjeteve financiare për RTK- në

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që para deputetëve të arsyetojë Rekomandimin.

Gani Koci u fokusua në kërkesën e Bordit të RTK-së për ndarjen e mjeteve për financimin e përkohshëm të RTK-së, në periudhën prej 1 janar – 30 qershor 2010.

Ai në vazhdim i lexoi në tërësi Rekomandimet e komisionit funksional.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndarjen mjeteve financiare për RTK- në

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfara Shinik, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, **Kryetari** hodhi në votim miratimin e Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndarjen mjeteve financiare për RTK- në. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----49,
Kundër-----11,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për financimin e përkohshëm të Radio-Televizionit të Kosovës për periudhën 1 janar - 30 qershor 2010, në shumën prej 5.264.000 (pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e katërmijë) Euro.
Obligohet, Qeveria - Ministria e Ekonomisë dhe Financave, që për mbulimin e kësaj shume të ndajë mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës të vitit 2010, nga kategoria ekonomike – Mallra dhe Shërbime.
2. Obligohet RTK-ja, KEK-u dhe Ministria e Ekonomisë dhe të Financave që të definojë borxhet e KEK-ut ndaj RTK-së për faturat e papaguara në të gjitha periudhat deri në datën e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për masën e përkohshme për parapagimin e RTK-së.
3. Deri më 15 mars 2010, Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i dorëzohet Raporti i auditimit të jashtëm, të pavarur, për pasqyrat financiare dhe të performancës së RTK-së për vitin 2009. Kostoja e shpenzimeve të auditimit ndahet nga shuma e përgjithshme në pikën 1 të këtij vendimi.

15. Propozim-vendimi i Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale

Kryetari ftoi kryetaren e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që para deputetëve të arsyetojë Raportin me Rekomandime, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale.

Myzejene Selmani tha se Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin në seancë plenare.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Et'hem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, **Kryetari** hodhi në votim miratimin e Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----45,
Kundër-----22,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR MINIERA DHE
MINERALE

1. Anëtarë të Komisionit për Miniera dhe Minerale, emërohen:
 - Ahmet Tmava,
 - Xhevdet Kastrati,
 - Ibush Jonuzi dhe
 - Shaip Latifi
2. Mandati i anëtarëve të Komisionit për Miniera dhe Minerale zgjat katër (4) vjet.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare

Kryesuesi ftoi ministrin e Punëve të Jashtme që para deputetëve ta prezantojë projektligjin.

Ministri **Skender Hyseni** tha se Projektligji për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare është një detyrim i yni, i cili buron nga Deklarata e Pavarësisë dhe detyrimet kushtetuese. Nëpërmjet këtij ligji shteti ynë rikonfirmon edhe një herë krijimin e kushteve në të mirë të ruajtjes së paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, luftimin e terrorizmit ndërkombëtar dhe në ruatjen dhe forcimin e interesave shtetërore të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, tha se sanksionet kanë të bëjnë me vendosjen e tyre nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, të cilat iu referohen konflikteve etnike, fetare dhe sanksioneve të tjera të cilat janë specifikuar në këtë projektligj.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit parlamentar për Punë të Jashtme, Ibrahim Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamit, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, si dhe deputetët: Gjylnaze Sylja, Skender Hyseni, Bahri Hyseni, Arsim Rexhepi, Ramadan Avdiu, Sabri

Hamiti, Gani Buçinca, Berim Ramosaj dhe Shkumbin Demaliaj, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----45,
Kundër-----8,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Jashtme, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese

Kryesuesi ftoi ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, që para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

Ministri **Lutfi Zharku** tha se Projektligji për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese rregullon: organizimin dhe kompetencat e mbikëqyrjes inspektuese të tregut në Republikën e Kosovës, si dhe mbikëqyrjen e të drejtave të konsumatorëve.

Në vazhdim tha se gjatë vitit të kaluar janë bërë 4000 inspektime nga kjo fushë.

Deri më tani, tha ministri, me ligjin në fuqi, rregullimi i funksionimit të tregut bëhet në dy nivele, mirëpo ky dualizëm ka shkaktuar vështirësi në funksionimin e inspektimit të tregut. Ai përmendi edhe nenin 4 të ligjit në fuqi, i cili nuk ka mund të zbatohet në praktik, mirëpo këto të meta janë eliminuar me projektligjin të cilin po e shqyrtojmë sot, konstatoi ministri.

Në fund ai i ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nerxhivane Dauti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Kolë Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysa, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, si dhe deputetët: Adem Hajdaraj, Riza Smaka, Naim Maloku dhe Nekibe Kelmendi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,
Kundër-----2,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pas përfundimit të kësaj pike, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, propozoi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet, më 29 janar 2010.

Kryesuesi kërkoi nga deputetët të deklarohen me votim formal për propozimin e Lutfi Hazirit.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin e Lutfi Hazirit, për vazhdimin e seancës plenare, më 29 janar 2010, në orën 10:00.

Seanca i përfundoi punimet në orën 17:15 minuta.

E premte, 29 janar 2010, ora 10:00

Vazhdimi i seancës plenare

Seancën plenare e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kurse i ndihmoi anëtari i Kryesisë, **Naim Maloku**.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje

Kryetari ftoi zëvendëskryeministrin, **Ramë Manaj**, që para deputetëve ta prezantojë projektligjin.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** tha se kompletimi i infrastrukturës ligjore vazhdon të jetë nevojë imediate edhe për këtë lëmë.

Në vazhdim, tha se ky projektligj ka për qëllim krijimin e mekanizmave adekuat për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave nga dhuna në familje, mosdiskriminimin ndaj femrës, trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe përballimin e pasojave, duke përfshirë këtu asistencën sociale, ndihmën mjekësore, etj.

Ky projektligj është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është në pajtim me standardet evropiane nga kjo lëmë, tha zëvendëskryeministri.

Në fund, ai i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nerxhivane Dauti, në emër të Grupit Parlamentar të

LDK-së dhe të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Luljeta Shehu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Drita Maliqi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, si dhe deputetët: Melihate Termkolli, Edita Tahiri, Sanije Aliaj, Driton Tali, Gjylnaze Syla, Hydajet Hyseni, Ardian Gjini, Drita Kadriu, Riza Smaka, Donika Kadaç-Bujupi, Flora Brovina, Adem Hajdaraj, Gani Buçinca, Nekibe Kelmendi dhe Bahri Hyseni, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për mbrojtje nga dhuna në familje.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë

Kryesuesi ftoi ministren **Justina Pula - Shiroka**, që para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

Ministrja **Justina Pula - Shiroka** tha se ky projektligj është rezultat i punës së vazhdueshme për kompletimin e infrastrukturës ligjore nga fusha e energjisë.

Në vazhdim, ajo tha se Projektligji për energjinë ka rëndësi të veçantë, sepse do të mbështesë zhvillimin e ekonomik të vendit. Në zbatimin e ligjit në fuqi janë vërejtur mangësi mjaft evidente dhe mu për këtë arsye shtrohet nevoja e miratimit të këtij projektligji, si domosdoshmëri për rritjen e sektorit të energjisë, tha ajo. Ajo, gjithashtu, potencoi si arsye tjetër për draftimin e këtij projektligji edhe rregullativat më të reja të bashkësisë evropiane nga kjo fushë.

Qëllimi i projektligjit është përcaktimi i rregullave për shfrytëzimin me efikasitet të energjisë, gjenerimin e burimeve të reja etj.

Në draftimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë edhe operatorët e transmissioinit dhe ekspertët nga Brukseli, tha ministrja.

Në fund, ajo i ftoi deputetët për miratimin, në parim, të Projektligjit për energjinë.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për energjinë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar

të LDD-së, Lulzim Zeneli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, si dhe deputetët: Driton Tali, Riza Smaka, Edita Tahiri, Zylfi Merxha dhe Melihate Termkolli, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----37,
Kundër-----21,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për energjinë. Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike

Kryesuesi ftoi ministren **Justina Pula - Shiroka**, që para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

Ministrja **Justina Pula - Shiroka** tha se ligji në fuqi për energjinë elektrike ka disa paqartësi.

Në vazhdim, theksoi se Projektligji për energjinë elektrike ka për qëllim: zhvillimin e tregut konkurrues, krijimin e kushteve për prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, si dhe sigurimin e masave për mbrojtjen e konsumatorëve.

Në fund, ajo i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për energjinë elektrike.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për energjinë elektrike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, si dhe deputetët: Driton Tali, Riza Smaka dhe Naim Rustemi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----29,
Kundër-----29,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi Projektligjin për energjinë elektrike.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë

Kryesuesi ftoi ministren **Justina Pula - Shiroka**, që para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

Ministrja **Justina Pula - Shiroka** tha se ky projektligj rregullon mënyrën e funksionimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si agjenci e pavarur.

Në vazhdim, theksoi se projektligji përcakton detyrat, kompetencat dhe kushtet për dhënien e licencave për aktivitetet nga kjo fushë.

Ky projektligj nuk e cenon rregullativën evropiane nga kjo fushë.

Në fund, ajo i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, si dhe deputetët: Naim Rustemi, Ibrahim Makolli, Naser Rugova, Driton Tali, Fatmir Rexhepi dhe Ethem Çeku, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----35,
Kundër-----30,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Kuvendi ngarkoi: Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport, dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mjekësinë Ligjore

Kryesuesi ftoi ministren **Nekibe Kelmend**, që para deputetëve ta prezantojë projektligjin.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** tha se ky projektligj është draftuar nga ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertë të tjerë dhe se me këtë kompletohet legjislacioni nga mjekësia ligjore.

Në vazhdim, tha se projektligji rregullon: procedurën, vendin dhe afatet kohore për ekzaminimet mjekoligjore, duke iu përmbajtur parimit të fshehtësisë profesionale.

Ky projektligj krijon bazën ligjore për zhvarrosjen e kufomave, përcakton se ekspertët e mjekësisë ligjore në bazë të procedurave me ligj kryejnë autopsinë dhe zhvillimet lidhur me rastin e vdekjeve jonatyrore, të lëndimeve, llojet dhe kohën e atyre lëndimeve, tha ajo. Me këtë projektligj do të rritet efikasiteti i gjyqësorit dhe do t'u kthehet besimi qytetarëve në sistemin e drejtësisë, potencoi ministrja.

Ajo tha se ky projektligj e ka një kosto financiare prej 290.000 euro, për vitin 2010.

Në fund, ajo i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për Mjekësinë Ligjore.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Mjekësinë Ligjore.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmire Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, si dhe deputetët: Gjylnaze Sylja, Shkumbin Demaliaj, Naser Rugova, Lulzim Zeneli, Riza Smaka dhe Nekibe Kelmendi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,

Kundër-----0,

Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Projektligjin për Mjekësinë Ligjore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, që ta marrë fjalën.

Hydajet Hyseni tha se Komisionit Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës ka bërë intervistimin e një numri mjaft të madh të kandidatëve të paraqitur. Komisioni, pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes, në pajtim me Rregulloren 2008/12 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, i rekomandon Kuvendit si kandidatë të mundshëm për pozitën- anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës:

1. Naim Abazin dhe
2. Ali Dragushën.

Kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që të caktojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

Elheme Hetemi, nga PDK-ja, kryetare e Komisionit votues,
Anita Morina, nga LDK-ja, anëtare,
Ibrahim Selmanaj, nga AAK-ja, anëtar,
Njomza Emini, nga AKR-ja, anëtar,
Drita Maliqi, nga LDD-ja, anëtare,
Myfera Shinik, nga Grupi “7+”, anëtare dhe
Kosara Nikoliq, nga SLS, anëtare

Pas procedurës së votimit, kryetarja e Komisionit votues, Elheme Hetemi i deklaroi rezultatet e votimit, si në vijim:

1. Në votim kanë marrë pjesë gjithsejt 67 deputetë,
2. Për kandidatin Naim Abazi kanë votuar 39 deputetë,
3. Për kandidatin Ali Dragusha kanë votuar 21 deputetë,
4. Shtatë fletëvotime kanë qenë të pavlefshme.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori vendim që Naim Abazi të emërohet anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Në vazhdim, kryesuesi e njoftoi Kuvendin lidhur me përfaqësimin e deputetëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare dhe joserbe, me rotacion në Kryesi të Kuvendit. Ai tha se radha dhe kohëzgjatja e mandatit është caktuar, si në vijim:

1. Viti i parë, VAKAT - 12 muaj, (Xhezair Murati, prej 31.1. 2008 deri 28.5.2009),
2. Viti i dytë, KDTP- 12 muaj, (Myfera Shinik, prej 28.5.2009 deri më 31.1.2010),
3. Viti i tretë dhe i katërt, nga gjashtë (6) muaj, si në vijim:
 - PDAK- 6 muaj, prej 1.2 deri më 30.7. 2010,
 - SDA- 6 muaj, prej 1.8 2010 deri më 31.1.2011,
 - IRDK- 6 muaj, prej 1.2 deri më 30.7.2011 dhe
 - PREBK- 6 muaj, prej 1.8.2011 deri në përfundim të mandatit të kësaj legjislature.

Sipas kësaj marrëveshje, që nga data 1 shkurt 2010 deri me 30 qershor 2010, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, është përfaqësuesi i PDAK-së.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 17:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale